

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS  
ZYRA E REGJISTRIMIT DHE CAKTIMIT TE NXENESVE  
440 NORTH BROAD STREET, SUITE 111  
PHILADELPHIA, PA 19130

Danielle Seward  
Zëvendës Kryetar

Tel.: 215-400-4290  
Faks: 215-400-4291

25 Mars 2014

I dashur Nxënës, ose Prind/Kujdestar,

Drejtoria është në procesin e pranimit të aplikimeve me përzgjedhje me lotari nga nxënësit e klasave të teta, të cilët dëshirojnë të ndjekin Shkollat e Mesme të Kensington\_it dhe Shkollat e Mesme të Reja të Drejtorisë Arsimore. Lotaria është një mundësi për nxënësit, që janë aktualisht në klasat e teta, që të aplikojnë në shkollat e listuara më poshtë, për pranim në klasat e nënta. Ju lutemi i shqyrtoni me vëmendje Shkollat e Kensington\_it dhe Shkollat e Reja të Drejtorisë, të renditura më poshtë dhe vizitoni uebsajtet e tyre, për të mësuar më tepër rreth atyre shkollave. Ne e kuptojmë që ju, ose fëmija juaj nuk është përzgjedhur në shkollën që keni dëshiruar nëpërmjet procesit të fundit të aplikimit për shkollën e mesme. Drejtoria Arsimore dëshiron të sigurohet që ju jeni i interesuar për këtë mundësi.

<b>Emri i Shkollës</b>	<b>Vendi</b>
<i>Building 21</i> <a href="http://www.b-21.org">www.b-21.org</a>	<i>2000 N. 7th Street, 19122</i>
<i>Kensington CAPA</i> <a href="http://kensingtoncapa.wix.com/kcapa">http://kensingtoncapa.wix.com/kcapa</a>	<i>1901 N. Front Street, 19122</i>
<i>Kensington Health Science Academy</i> <a href="http://www.philasd.org/schools/kensington-health-sciences">http://www.philasd.org/schools/kensington-health-sciences</a>	<i>2495 Emerald Street, 19125</i>
<i>Kensington International Business, Finance, &amp; Entrepreneurship</i> <a href="http://philasd.org/schools/kensington-business">http://philasd.org/schools/kensington-business</a>	<i>2501 Coral St, 19125</i>
<i>Kensington Urban Education</i> <a href="https://webapps.philasd.org/school_profile/view/5600">https://webapps.philasd.org/school_profile/view/5600</a>	<i>2051 E. Cumberland Street, 19125</i>
<i>The LINC High School</i> <a href="http://www.the-linc.org">www.the-linc.org</a>	<i>122 W. Erie Avenue, 19140</i>
<i>The U School</i> <a href="http://www.uschool.org">www.uschool.org</a>	<i>2000 N. 7th Street, 19122</i>

**Kush mund të aplikojë?**

Të gjitha shkollat e renditura nuk janë selektive (non-selective), dhe nuk kanë kërkesa që lidhen me mësimet, ose sjelljen për pranime. Mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e klasave të teta. Ju lutemi bëhuni me dije, që nxënësve që aplikojnë për Shkollën “Kensington CAPA” do t’u kërkohet një audicion për programet e arteve, që ofrohet në këtë shkollë.

**Si të aplikoj**

Nxënësit e interesuar mund të paraqesin aplikimin online në <http://philasd.org/kensington-new-high-schools-lottery>. Aplikimet do të pranohen prej ditës së Hënë, datë 24 Mars deri ditën e Premte, datë 25 Prill, ora 5:00 p.m.. Familjet do të njoftohen për rezultatin e lotarisë, gjatë javës së datës 9 Qershor.

**Vizitat e Hapura në Shkollat e Reja të Drejtorisë**

Drejtuesit që kanë Projektuar Shkollat nga “The U School, Building 21 dhe The LINC” do të presin vizitorë pa njoftim paraprak (vizitë e Hapur) në datat e mëposhtëme, për t’ju paraqitur vizionin e tyre dhe synimet për secilin model, duke shpjeguar procesin e regjistrimit dhe duke u përgjigjur pyetjeve nga prindërit dhe nxënësit. Do të ketë Laptope për nxënësit që do të dëshirojnë të aplikojnë.

**E Mërkurë 9 Prill**  
APM Hall  
6 PM deri 8 PM  
2319 North 7<sup>th</sup> Street

**E Premte 11 Prill**  
Enon Tabernacle Baptist Church  
5 PM deri 8 PM  
2800 West Cheltenham Avenue

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS  
ZYRA E REGJISTRIMIT DHE CAKTIMIT TE NXENESVE  
440 NORTH BROAD STREET, SUITE 111  
PHILADELPHIA, PA 19130

Danielle Seward  
Zëvendës Kryetar

Tel.: 215-400-4290  
Faks: 215-400-4291

**Informacion Shtesë**

Për përditësime dhe informacion shtesë për Lotarinë në Shkollat e Mesme të Kensington\_it dhe Shkollat e Reja, ju lutemi vizitoni [http://philasd.org/kensington-new\\_high\\_schools\\_lottery](http://philasd.org/kensington-new_high_schools_lottery).

Për informacion shtesë për Proçesin e Lotarisë, telefononi Zyrën e Regjistrimit dhe Caktimit të Nxënësve me numër 215-400-4290. Për të mësuar më tepër rreth Modeleve të Shkollave të Reja, ju lutemi telefononi 215-400-4840, ose vizitoni [www.philasd.org/newschoolmodels](http://www.philasd.org/newschoolmodels).

Të katër shkollat e Kensington\_it dhe shkollat e reja të drejtorisë arsimore, paraqesin mundësi emocionuese për nxënësit e klasave të teta të Filadelfias. Ne shpresojmë, që ju do të gjeni kohën e nevojshme për të mësuar më tepër dhe të vlerësoni aplikimin në këto shkolla.

Sinqerisht,



Danielle N. Seward  
Zëvendës Kryetar, Për Regjistrimin dhe Caktimin e Nxënësve

Cc: Principals and Counselors